

VENDIM
Nr.413, datë 24.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËS SË
PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në nënndarjen Ministria e Drejtësisë, në lidhjen nr.3, që përmendet në pikën 8 të vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtesa “Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor” të zëvendësohet me “Inspektor për Inspektimin Gjyqësor; Inspektor për Inspektimin e Prokurorisë dhe Inspektor për Inspektimin Administrativ”.

2. Efektet financiare, për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 25.2.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha